

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

PKR.nr.632/14

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja Shadije Gërguri –kryetare e trupit gjykues, gjyqtarët Beqir Kalludra dhe Shashivar Hoti si anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtorin profesional Driton Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.I. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.835/2013, i dt: 12.11.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, verbal e publik, në prezencën e prokurorit të shtetit Ilaz Beqiri dhe të akuzuarit A.I., të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit:

A.I., nga i ati S. dhe eëma F., e vajzërisë Z., i lindur më dt...., në fsh. D. e P., KK P., ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar si v. i autobusave, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal

Konform nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPPK-së,

REFUZOHEȚ AKTAKUZA

SE:

Nga kohë e pacaktuar e deri më dt.18.08.2013 i akuzuari pa autorizim ka mbajtuar armën e tipit “Ekol” me nr. serik EJ12122270, ashtu që gjatë një kontrolli rutinor është ndaluar dhe kontrolluar vetura e tipit Pasat, ngjyrë hiri metalike, me traga ..., në të cilën si pasagjerë ishte i akuzuari A.I. dhe gjatë kontrollimit janë gjetur 13 copa fishekë të kalibrit 9mm, ndërsa të njëjtën ditë i njëjti ka dorëzuar në Stacionin Policor – Qendra armën e lartëcekur të mbajtur pa autorizim-

- me këtë kishte për të kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374, par.1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor ka hequr dorë nga ndjekja penale.

Konform nenit 374, par.3 të KPRK-së, konfiskohet arma e tipit “Ekol” me nr. serik EJ12122270 dhe 13 copa fishekë të kalibrit 9mm dhe të njëjtat do të shkatërrohen pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për krime të rënda ka ngritur aktakuzë PP.nr.835/2013, i dt: 12.11.2014, kundër të akuzuarit A.I. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374, par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me dt.20.12.2018, në të cilën prokurori i shtetit ka hequr dorë nga ndjekja penale me arsyetimin se nga provat të cilat posedon prokurori i shtetit nuk rezulton dyshimi i bazuar mirë se i akuzuar A.I. ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Andaj, duke marrë parasysh se prokurori i çështjes gjatë shqyrtimit gjyqësorë është tërhjekur ngaakuza kundër të akuzuarit A.I., gjykata konform nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPPRK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket konfiskimit, gjykata vendosi në bazë të nenit 374 par. 3 të KPRK-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës penale, Gjykata e ka bazuar në nenin 454 par. 1 të KPPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDË
PKR.nr.632/14, të dt. 20.12.2018**

**Bashkëpunëtori profesional
Driton Berisha**

**Kryetarja e trupit gjykues - Gjyqtarja
Shadije Gërguri**

KESHILLË JURIDIKE: Aktgjykimi bëhet i plotëfuqishëm nga data e shpalljes së të njëjit, meqënëse palët kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës.